

2013



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Raporti fiskal mujor

Janar - Gusht, 2013

Tabela e përmbajtjes

1	Analizë e përgjithshme	3
	Buxheti i konsoliduar	3
	Shpërndarja e të ardhurave sipas burimit	5
2	Analiza sipas të ardhurave	7
	Tatimet mbi konsumin: Tatimi mbi Vlerën e shtuar	7
	Tatimet mbi konsumin: Akciza	8
	Taksimi i tregtisë ndërkombëtare: Taksa doganore.....	9
	Taksimi i të ardhurave.....	9
	Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	11
	Të ardhura të tjera vendore	12
	Të ardhura jotatimore	12
3	Analiza e shpenzimeve për periudhën janar-gusht 2013	13
	Vështrim i përgjithshëm	13
	Shpenzimet korrente	13

1 ANALIZË E PËRGJITHSHME

Buxheti i konsoliduar

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 8-mujore arritën në 210.6 miliardë lekë, 7.2 për qind më pak se parashikimi për 8-mujorin e vitit 2013 dhe 3.8 për qind më pak se një vit më parë (tabela1).

Të ardhurat nga ndihmat për periudhën janë 2.6 miliardë lekë, 42% më pak se parashikimi dhe 26.6% më shumë se shifra e një viti më parë. Të ardhurat tatimore arritën në 191.8 miliardë lekë, rreth 8.6% më pak se parashikimi dhe 4.3% më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat ishin në nivelin 145 miliardë lekë, ose rreth 16.7 miliardë lekë më pak nga rreth 161.7 miliardë lekë të planifikuara për periudhën, dhe 5.8 për qind më pak krahasuar me të njëjtin 8-mujor të një viti më parë, ose 8.9 miliardë lekë në terma absolutë. Të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 7.1 miliardë lekë nga 8.3 miliardë lekë të planifikuara për këtë periudhë (14.0% më pak) dhe me rënie vjetore prej 12.8 për qind. Të ardhurat nga fondet speciale arritën 39.8 miliardë lekë brenda parashikimeve, me rritje vjetore 3.3%; të ardhurat jotatimore kanë qenë për këtë periudhë 16.1 miliardë lekë me një tejkalim të ndjeshëm ndaj parashikimit prej 30% dhe me rënie vjetore 1.1 për qind.

Sipas agjencive të mbledhjes, administrata doganore ka mbledhur 87.6 miliardë lekë, me rritje vjetore 7.1 për qind. Sipas zërave të të ardhurave që mbledhin doganat, dy zërat me rritje janë akciza dhe renta minerare në eksport, që janë rritur mbi baza vjetore përkatësisht 61.2 dhe 46.8 për qind. Rritja e ndjeshme e të ardhurave nga akciza lidhet me kalimin e mbledhjes së akcizës tërësisht tek administrata doganore, nga muaji tetor 2012. Të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) në import janë 55.2 miliardë lekë me rënie vjetore 7.3 për qind.

Tabela 1. Indikatorët fiskalë 8-mujorë.

Miliardë lekë	8m 2009	8m 2010	8m 2011	8m 2012	8m 2013
TË ARDHURAT TOTALE	194,709	206,087	210,910	218,862	210,553
SHPENZIMET TOTALE	242,516	229,266	242,100	242,581	264,911
Nga të cilat SHPENZIME KORRENTE	177,328	192,241	199,607	204,569	216,997
Nga të cilat SHPENZIME KAPITALE	65,103	40,241	42,493	36,012	47,914
BALANCA FISKALE	-47,806	-23,179	-31,190	-23,719	-54,358
BALANCA PRIMARE	-24,003	3,372	-5,333	3,201	-25,942

Burimi: Ministria e Financave.

Administrata tatimore ka mbledhur (pa përfshirë kontributet) 57.3 miliardë lekë, rreth 20.4 për qind më pak të ardhura se 8-mujori i vitit 2012, ose 14.7 miliardë lekë më pak. Të ardhurat nga kontributet janë rritur me 2.6 për qind mbi baza vjetore. Ecuri pozitive ka patur për këtë periudhë vetëm tatimi mbi të ardhurat personale që ka pësuar një rritje prej 8.7 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë; ndërsa tatimi mbi vlerën e shtuar ka rënë me 11.3 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë në vitin 2012.

Tabela 2. Të ardhurat në buxhetin e konsoliduar (miliardë lekë).

Nr.	E M È R T I M I	8M-2009	8M-2010	8M-2011	8M-2012	8M-2013
	TOTALI TË ARDHURAVE	194,709	206,087	210,910	218,862	210,553
I.	Të ardhura nga ndihmat	1,708	1,991	1,746	2,043	2,593
II.	Të ardhura tatimore	178,777	187,797	195,528	200,496	191,822
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	136,571	144,314	150,100	153,839	144,955
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	71,136	74,091	74,387	76,371	70,126
2	Tatimi mbi Fitimin	11,497	11,667	13,962	11,647	10,279
3	Akcizat	22,507	25,391	26,199	24,592	23,464
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	18,121	17,459	18,255	17,924	19,430
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	8,423	11,143	12,803	19,302	18,065
6	Taksa Doganore	4,887	4,563	4,494	4,003	3,591
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	8,600	7,968	8,110	8,139	7,095
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	1,088	1,413	1,309	2,007	1,804
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	1,806	1,764	2,141	1,576	1,466
3	Taksa Lokale	5,706	4,791	4,660	4,556	3,825
II.3	Të ardh nga fondet speciale	33,607	35,514	37,318	38,518	39,772
1	Sigurimi Shoqëror	30,068	29,934	32,142	32,799	33,599
2	Sigurimi Shëndetësor	3,539	4,342	4,063	4,816	4,875
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve		1,238	1,113	903	1,298
III.	Të ardhura Jotatimore	14,224	16,299	13,636	16,323	16,138
1	Tran. Fitimi nga Banka e Shqipërisë	2,241	3,436	4,110	3,343	4,163
2	Të ardhura nga Inst. Buxhetore	7,788	6,871	5,348	6,080	7,260
3	Dividenti	1,186	543	807	174	927
4	Tarifat shërbimeve	2,651	1,653	2,254	2,729	2,070
5	Të tjera	359	3,796	1,117	3,997	1,718

Burimi: Ministria e Financave.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të muajit gusht 2013 arritën në rreth 264.9 miliardë lekë nga rreth 273.9 miliardë lekë të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 96.7 për qind të parashikimit të periudhës. Krahasuar me një vit më parë shpenzimet e buxhetit të konsoliduar rezultojnë rreth 9.2 për qind më të larta. Shpenzimet korrente ishin 6.1% më shumë se një vit më parë, ndërsa ato kapitale ishin 33.1% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë (tabela 1).


Deficiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në këtë 8-mujor në 54.4 miliardë lekë, 7.2 miliardë lekë më shumë se planifikimi dhe 30.6 miliardë më i lartë se e njëjta periudhë e një viti më parë (tabela 1). Deficiti është financuar në pjesën më të madhe me burime të brendshme (kryesisht huamarrje): 15.9 miliardë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e deficitit; 23.5 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brendshme neto, ndërsa financimi i huaj neto i deficitit ka qenë në nivelin rreth 18.7 miliardë lekë (tabela 2).

Tabela 3. Financimi i deficitit 8M në vite.

Milionë lekë	8m 2009	8m 2010	8m 2011	8m 2012	8m 2013
Financimi i deficitit	47,798	23,179	31,190	23,719	54,358
I brëndshëm	43,265	18,650	23,966	12,285	43,006
-të ardhura nga privatizimi	20,343	230	335	735	15,960
-huamarrje	27,688	26,903	29,526	18,454	23,488
-të tjera	-4,767	-8,482	-5,895	-6,904	7,031
I huaj	4,533	4,529	7,224	11,434	11,352
-huamarrje afatgjatë	8,694	11,128	10,962	19,139	18,651
-ndryshimi i gjëndjes së llogarisë	-808	-2,750	546	-2,012	-239
-ripagesat	-3,353	-3,849	-4,284	-5,693	-7,060

Burimi: Ministria e Financave.

Figura 1. Financimi i brëndshëm kundrejt financimit të huaj (në % ndaj totalit).



Burimi: Ministria e Financave.

Shpërndarja e të ardhurave sipas burimit

Të ardhurat tatimore për periudhën përbëjnë rreth 91.1 për qind të të ardhurave në buxhetin e konsoliduar, grantet rreth 1.2 për qind dhe të ardhurat jotatimore 7.7 për qind të totalit në buxhet. Në grupin e të ardhurave tatimore, vendin dominues e kanë të ardhurat nga taksimi i konsumit të mallrave dhe shërbimeve (TVSH-ja dhe akciza), në një nivel prej 44.5 për qind të të ardhurave tatimore. Të ardhurat nga taksimi direkt i pasurisë dhe të ardhurave të individëve dhe bizneseve janë ende në një nivel modest për nga pesha e tyre në totalin e të ardhurave tatimore me 15.7 për qind. Veçanërisht "të parëndësishme" në këtë grup janë tatimet mbi pronën (ndërtesa dhe tokë bujqësore), sidomos nëse krahasohemi me vendet e zhvilluara (vetëm 0.9 për qind të totalit të të ardhurave tatimore); të ardhurat nga taksimi i tregtisë ndërkombëtare (tarifat doganore) janë prej vitesh në një trend rënës, në linjë me politikën tregtare liberalizuese (për 8-mujorin zënë vetëm 1.7 për qind).

Struktura e përgjithshme e të ardhurave nuk ka pësuar ndryshime thelbësore në dhjetëvjeçarin e fundit. Pjesa dërrmuese e të ardhurave tatimore vjen nga taksimi i konsumit, TVSH-së dhe akcizës, të cilat e kanë rritur peshën e tyre në strukturën e të ardhurave. Përqindja e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale (TAP) dhe tatimi mbi fitimin ka mbetur në nivele të stabilizuara prej 18-19 për qind, por vlen të theksohet se brenda këtij

grupi, taksimi i kompanive është ulur si rezultat i politikave tatimore nxitëse të investimit, ndërsa mbledhja e TAP-it është rritur ndjeshëm, si pasojë e masave administrative për rritjen e bazës së taksueshme të ndërmarra gjatë periudhës së reformës së "taksës së sheshtë". Shumë pak progres ka patur në mbledhjen e tatimeve mbi pasurinë (mbi tokën bujqësore dhe ndërtesat) për arsye të problematikave të vazhdueshme në regjistrimin e pasurisë dhe deklaratimet nga individët. Ecuri në rritje ka patur grupi i taksave nacionale, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

2 ANALIZA SIPAS TË ARDHURAVE

Tatimet mbi konsumin: Tatimi mbi Vlerën e shtuar

Tatimi mbi vlerën e shtuar është një nga zërat më problematikë për periudhën, me ulje vjetore të të ardhurave të mbledhura për periudhën rreth 8.2 për qind, duke qenë në nivelin 70.1 miliardë lekë (rreth nivelit të vitit 2008).

Të ardhurat e mbledhura nga importet ishin ndjeshëm nën nivelin e pritshëm, 55.2 miliardë lekë TVSH nga 61 miliardë të planifikuara, çka reflekton ecurinë e importeve gjatë kësaj periudhe. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 78.8 për qind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ato rezultojnë të jenë 4.3 miliardë lekë më pak, ose 7.3 për qind më të ulëta. Ecuria e TVSH-së së mbledhur në import është reflektim i ecurisë së importeve, të cilat për periudhën rezultojnë me rënie prej 5.3 për qind në nivel total mbi baza vjetore. Lidhur me efektet e politikës tatimore mbi të ardhurat nga TVSH-ja, bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) për periudhën janar-gusht, rezulton një shumë TVSH e përjashtuar mbi importin e makinerive dhe pajisjeve prej 500 milionë lekësh (VKM nr. 180, datë 13.2.2013, i ndryshuar).

Të ardhurat e mbledhura mbi furnizimet e brendshme janë 14.9 miliardë lekë TVSH për periudhën janar-gusht, me rënie vjetore në nivelin 11.3 për qind. Rimbursimi i TVSH-së për periudhën 8-mujore nga tatimet ka arritur 5.9 miliardë lekë me një rritje vjetore prej 29.5 për qind. Në strukturën e të ardhurave tatimore që mbledhin tatimet, vihet re ndryshimi i lehtë i peshës specifike të TVSH-së ndaj totalit, në 21.2 për qind në 8-mujorin 2012 dhe 2013.

Tabela 4. Rimbursimi i TVSH-së.

	Gush-12	Gush-13	Diferenca %	Jan-Gush 2012	Jan-Gush 2013	Diferenca %
TVSH BRUTO	12,578	10,209	-18.8	80,941	76,060	-6.0
nga Tatimet	4,134	2,421	-41.4	21,371	20,814	-2.6
nga Doganat	8,444	7,788	-7.8	59,570	55,246	-7.3
RIMBURSIM	774	787	1.6	4,570	5,934	29.9
nga Tatimet	774.3	786.8	1.6	4,569.4	5,916.4	29.5
nga Doganat	0.1	0		0.5	17.8	3230.8
RIMBURSIM PER KURUM*	0	0		0	3,473	
TVSH NETO	11,804	9,422	-20.2	76,371	70,126	-8.2
nga Tatimet	3,360	1,634	-51.4	16,802	14,898	-11.3
nga Doganat	8,444	7,788	-7.8	59,569	55,228	-7.3

**) Rimbursim i prapambetur i TVSH për Kurum Internacional kryer nga të hyrat e privatizimit të HEC-eve.
Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.*

Në strukturën e të ardhurave tatimore që mbledhin tatimet, vihet re rritje e peshës specifike të TVSH-së ndaj totalit, nga 23.3 për qind në 8-mujorin 2012 në 26.0 për qind për 8-mujorin 2013. Nga totali i të ardhurave nga TVSH-ja për 8-mujorin sipas sektorëve ekonomikë, në krahasim me 8-mujorin e vitit 2012, sektori që ka pësuar rritje është transporti përkatësisht

me 30.1 për qind. Sektorët me rënie të ndjeshme janë sektori i tregtisë me 42.1 %, sektori i shërbimeve me 8.7%, sektori i prodhimit me 4.4% dhe sektori i ndërtimit me 2.7%.

Tabela 5. Ndarja e TVSH-së sipas sektorëve dhe numri i tatimpaguesve.

Emërtimi	8M 2012 (mln)	8M 2013 (mln)	Ndryshimi (%)	8M 2012 (nr)	8M 2012 (nr)	Ndryshimi (%)
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	16,802.4	14,898.3	-11.3	12,282	12,003	-2.3
Prodhim	4,336.1	4,145.8	-4.4	1,337	1,168	-12.6
Ndërtim	3,210.7	3,123.4	-2.7	1,647	1,493	-9.4
Transport	200.7	261.1	30.1	335	357	+6.6
Tregti	2,685.1	1,555.2	-42.1	3,724	3,790	+1.8
Shërbime	6,369.8	5,812.9	-8.7	5,239	5,195	-0.8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Tatimet mbi konsumin: Akciza

Të ardhurat nga akciza për tetëmuajorin 2013 janë 23.5 miliardë lekë, ose 16.7 për qind më pak se parashikimi. Gjithashtu, ato rezultojnë më pak se shumata e tatimeve faktike me doganat për tetëmuajorin 2012, që do të thotë rënie të performancës së mbledhjes, si pasojë e periudhës tranzitore të kalimit të administrimit, por edhe e faktorëve të tjerë që lidhen me mallra specifike të akcizës, siç analizohet në vijim. Akciza ka performancën më të dobët të të ardhurave doganore të periudhës. Nga të dhënat e DPD-së, importi i mallrave kryesore të akcizës ka pësuar rënie në terma vjetorë, siç tregohet në tabelën 3 (me përjashtim të karburanteve që kanë një rritje të lehtë 2.4%). Në të ardhurat e mbledhura nga akciza kundrejt një viti më parë, ndikim kanë patur edhe ndryshimet në kohën e pagesës së taksës, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri "Për akcizat" (61/2012), sipas të cilit momenti i importit ndahet nga momenti i pagesës së akcizës, e cila bëhet e detyrueshme vetëm në momentin e hedhjes në qarkullim të mallit, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

Tabela 6 pasqyron të dhënat e zhdoganimeve ndërsa tabela 7 pasqyron ndarjen e të ardhurave nga akciza sipas grup-mallrave, bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Tabela 6. Importi i mallrave të forta, 8-mujorë.

Emërtimi	8M 2012	8M 2013	Ndryshimi	Ndryshimi (në %)
Karburante (ton)	271,076	277,660	6,584	+2.4
Cigare (ton)	2,248	2,057	-191	-8.5
Birra (000 litra)	21,992	20,751	-1,241	-5.6
Kafe (ton)	4,849	4,742	-107	-2.2

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Për këtë periudhë, të ardhurat nga akciza mbi produktet e duhanit shënojnë ulje të ndjeshme vjetore prej 40% në terma vjetorë (gjë e cila ndikon edhe ecurinë e përgjithshme të kësaj takse për peridhën në referim). Të ardhurat për mallrat e tjera kryesore paraqiten me rritje shumë të lehtë (karburante 4.4% rritje dhe pije alkoolike). Theksojmë se nuk ka patur ndryshime në nivelet e akcizës për produktet kryesore (pije alkoolike, cigare dhe karburante), gjatë 2012-2013. Lidhur me mallrat e tjera, përmendim ndryshimin e akcizës së kafes së pjekur, në fund të vitit 2012, në ulje nga 140 në 60 lekë dhe heqjen e akcizës së kafes së papjekur.

Tabela 7. Akciza e paguar sipas mallrave për periudhën janar-gusht 2013 (mln lekë).

Kategoria	Peshë neto (kg)	Vlerë akcize
Kafe	3,261,750	205,046,751
Birrë	44,554,830	849,244,252
Pije alkolike	3,527,222	336,431,010
Duhan, cigare	2,391,749	6,785,566,025
Produkte energjitike	465,439,333	15,392,260,483
Gomat	2,978,480	61,107,307
Bateritë	1,638,745	40,981,364
Llampat	1,300	1,489,400
Totali	523,793,409	23,672,126,592

Burimi: Ministria e Financave.

Taksimi i tregtisë ndërkombëtare: Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën janar-gusht janë rreth 3.6 miliardë lekë, 10.9 për qind më pak se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012. Të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 412 milionë lekë ose me 10.3 për qind. Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, taksa mesatare doganore për periudhën ka qenë 1.41 për qind nga 1.52 për qind e një viti më parë.

Taksimi i të ardhurave

Të ardhurat nga taksimi i të ardhurave individuale dhe fitimit të bizneseve arritën në 29.7 miliardë lekë, me rritje vjetore prej 0.6 për qind.

Taksimi i të ardhurave: Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 19.4 miliardë lekë për periudhën janar-gusht, ose 8.4 për qind më shumë se 8-mujorin e një viti më parë dhe 430 milionë më shumë se parashikimi i periudhës. Kontributin kryesor në ecurinë e përgjithshme pozitive të TAP-it e kanë patur tatimi mbi interesat, mbi dividendin dhe tatimi mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme (prej të cilave janë mbledhur rreth 1.5 miliardë më shumë se një vit më parë).

Tabela 8. Ndarja e TAP-it sipas llojit.

Emërtimi	8M 2012 (mln)	8M 2013 (mln)	Ndryshimi (mln lekë)	Ndryshimi(%)
Tatim mbi të ardhurat personale	17,870	19,427	+1,557	+8.7
Paga sektorit publik	5,938	6,128	+190	+3.2
Paga sektorit privat	6,181	5,829	-352	-5.7
Të ardhura nga interesat	2,022	2,322	+300	+14.8
Të ardhura nga dividenti	1,163	1,964	+801	+68.9
Të ardhura nga shitja e pasurisë së paluajtshme	137	491	+354	+258.4
Të tjera	2,429	2,693	+264	+10.9

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Të ardhurat nga tatimi mbi pagat janë thujtë në të njëjtin nivel me një vit më parë (me diferencë negative prej 162 milionë lekësh), në ndryshim nga sa pritej si efekt negativ për shkak të hyrjes në fuqi të përjashtimit nga taksimi i pagave deri në 30 000 lekë, që prej muajit qershor 2013. Ndikim në këtë zë ka patur edhe rritja e numrit të kontribuesve (kontribute dhe TAP), që sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) për periudhën 6-mujore është në total 11.650 njësi më shumë se e njëjtja periudhë e një viti më parë. Duhet theksuar se rritja e kontribuesve në sektorin privat është rritur ndjeshëm me 12685 kontribues.

Tabela 9. Diferenca në të ardhurat nga TAP-i mbi pagat sipas muajve 2013-2012.

TAP-i nga paga	mujore							
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht
Sektori publik	76,187	79,754	(24,175)	12,233	26,302	13,314	3,109	7,722
Sektori privat	19,427	(27,190)	20,106	27,251	(17,535)	(130,759)	(81,959)	(169,225)

Burimi: DPT.

Subjektet e biznesit të vogël që kanë qarkullim vjetor 2-8 milionë lekë, kanë paguar të ardhura personale në shumën 220 milionë lekë për 8-mujorin janar-gusht 2013 nga 123.6 milionë të vitit të kaluar ose 78 për qind më shumë, pavarësisht se numri i subjekteve tatimpaguese të kësaj kategorie ka pësuar rënie në total me 5.6%.

Taksimi i të ardhurave nga biznesi

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 8-mujorin 2013 arritën në rreth 10.3 miliardë lekë nga 11.6 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rënie prej 11.7 për qind dhe 4.4% më pak se parashikimi i periudhës janar-gusht 2013.

Nga totali i të ardhurave nga tatimi mbi fitimin për 8-mujorin 2013, rezultojnë me pagesa ndjeshëm më të ulëta se një vit më parë sektorët «prodhim energjie» dhe «ndërtim objektsh». Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në disa sektorë është reflektuar në rritjen e kërkesave nga subjektet për rishikim në ulje të kësteve të parapagimeve, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Këto kërkesa kanë të bëjnë me ndërprerje të kontratave të punës dhe mosrealizim të njëjtë të qarkullimit të pritshëm për periudhën në vijimësi.

Të ardhurat nga taksat vendore mbi biznesin e vogël arritën në 1.5 miliardë lekë, me rënie vjetore prej 7 për qind. Krahas problemeve të administrimit të taksës, sipas të dhënave më të fundit nga Administrata Tatimore, rezulton që numri i subjekteve të biznesit të vogël, me xhiro vjetore nën 8 milionë lekë, ka pësuar një rënie prej 3360 njësisish krahasuar me një vit më parë.

Tabela 10. Ndarja e tatimit fitimit sipas sektorëve dhe numri i kontribuesve.

	8M 2012 (mln)	8M 2013 (mln)	Ndryshimi (%)	8M 2012 (nr)	8M 2013 (nr)	Ndryshimi (%)
Tatim fitimi	11,646.4	10,278.9	-11.7	10,783	10,009	-7.2
Prodhim	2,990.6	2,467.5	-17.5	1,771	1,539	-13.1
Ndërtim	1,686.7	1,108.5	-34.3	1,701	1,438	-15.5
Transport	225.5	202.4	-10.2	445	425	-4.5
Tregti	2,650.9	2,130.0	-19.7	4,991	4,789	-4.0
Shërbime	4,092.6	4,370.5	+6.8	1,875	1,818	-3.0

Burimi: DPT.

Taksimi i pasurisë

Për qëllime analize, këtu përfshijmë tatimin mbi ndërtesat dhe mbi tokën bujqësore. Për 8-mujorin taksat mbi pasurinë arrijnë në 1.8 miliardë lekë nga 2.1 miliardë lekë të parashikuara dhe 10.1 për qind më të ulëta se një vit më parë.

Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale për periudhën janë 18.1 miliardë lekë, 1.7 miliardë më pak se parashikimi dhe 1.2 miliardë më pak se një vit më parë (6.4% më pak në terma vjetorë). Efekt negativ kanë patur zërat: taksa mbi mjetet e përdorura të transportit si pasojë e përgjysmimit të taksimit duke filluar nga muaji qershor 2013 (rreth 500 milionë lekë më pak se një vit më parë); taksa e karbonit; tatimi mbi lojërat e fatit (rreth 1 miliardë lekë më pak). Rritje të ndjeshme kanë patur të ardhurat nga taksa e qarkullimit (mbi karburantet) me rreth 150 milionë lekë; renta me rreth 1.1 miliardë lekë më shumë (dogana ka mbledhur 1.78 miliardë lekë më shumë, ndërsa tatimet afërsisht 600 milionë lekë më pak se një vit më parë, kryesisht prej kompanisë Albpetrol).

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Të ardhurat nga fondet speciale për periudhën janar-gusht 2013 arritën në 39.8 miliardë lekë, me një rritje prej 3.3 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë dhe në linjë me parashikimin për periudhën. Ky grup të ardhurash përbën rreth 21 për qind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, rreth 38.5 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 1.3 miliardë lekë të ardhura për kompensimin në vlerë të pronarëve.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 33.6 miliardë lekë, me rritje vjetore 2.4 për qind; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 4.9 miliardë lekë, 1.2 për qind më shumë se 8-mujori i një viti më parë.

Për sa i takon bazës së taksueshme, të dhënat më të fundit të disponueshme janë ato të 6-mujorit nga Administrata Tatimore. Sipas tyre, rezulton se në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektori shtetëror dhe sektori privat) prej 2.75 për qind, ose rreth 11,650 njësi, kundrejt mesatares 6-mujore të 2012, nga ku sektorët e tregtisë dhe shërbimeve patën rritje përkatësisht me 12.87% dhe 2.86%. Ndërsa sektorët e tjerë pësuan ulje dhe përkatësisht sektori i prodhimit 2.14%, sektori i ndërtimit 4.37% dhe sektori i transportit 7.38% më pak se mesatarja e së njëjtës periudhë të një viti më parë.

Tabela 11. Numri mesatar i të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve.

	2012	2013	Ndryshimi në numër	%
Ndërmarrjet Buxhetore	138,204	138,095	-109	-0.08%
Ndërmarrjet Shtetërore	20,716	20,139	-398	-2.78%
Subjektet Private T.V.SH.	186,821	197,754	+11,283	5.85%
Subjektet Biznes i Vogël	77,415	78,817	+1,402	1.81%
Total	423,155	434,805	+11,650	2.75%

Burimi: DPT.

Të ardhura të tjera vendore

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën janar-gusht 2013 arritën në 7.1 miliardë lekë nga 8.2 miliardë lekë të planifikuara, ndërsa kundrejt 8-mujorit të vitit 2012 të ardhurat janë ulur me 1 miliardë lekë (rreth 12.8 për qind më pak). Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogël dhe taksat mbi pasurinë) kanë mbledhur rreth 3.8 miliardë lekë nga 4.8 miliardë lekë të parashikuara, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar këto taksa kanë pësuar një rënie prej 16 për qind.

Të ardhura jotatimore

Të ardhurat jotatimore përbëjnë 7.7 për qind të totalit të të ardhurave. Kategoritë më të rëndësishme të këtij grupi janë: transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë, të ardhura nga dividendë, tarifat e shërbimeve dhe të ardhurat nga institucionet buxhetore. Për periudhën 8-mujore 2013, të ardhurat jotatimore janë 16.1 miliardë (rreth nivelit të një viti më parë), me 29.9 për qind mbi parashikimin e periudhës.

3 ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN JANAR-GUSHT 2013

Vështrim i përgjithshëm


Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të muajit gusht 2013, arritën në rreth 264.9 miliardë lekë, nga rreth 273.9 miliardë lekë të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 96.7 për qind të parashikimit të periudhës ose me një mosrealizim prej rreth 9.0 miliardë lekësh.

Në analizën e shpenzimeve për periudhën janar-gusht 2013 duhet mbajtur parasysh fakti se në realizimin faktik të tyre, janë përfshirë edhe shpenzimet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe nga fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit.

- Fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i planifikuar në 1.41 miliardë lekë deri në fund të muajit gusht 2013, është ekzekutuar në rreth 1.31 miliardë lekë, nga të cilat rreth 45 milionë lekë për shpenzime personeli, rreth 1.16 miliardë për shpenzime të tjera korrente dhe rreth 99.4 milionë lekë për investime.
- Fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit, i planifikuar në rreth 800 milionë lekë deri në fund të muajit gusht 2013, është përdorur në rreth 512.57 milionë lekë, nga të cilat 200.0 milionë lekë për shpenzime korrente për mbështetje të bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe rreth 312.57 milionë lekë për investime.

Krahasuar me planin vjetor (që përfshin edhe të hyrat e privatizimit të katër hidrocentraleve), këto shpenzime janë realizuar në rreth 62.8 për qind, ndërsa kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 22.3 miliardë lekë më shumë ose rreth 9.2 për qind më të larta. Ecuria e shpenzimeve buxhetore në terma absolutë, si dhe ritmi i rritjes së tyre gjatë periudhës janar-gusht në disa vite, paraqitet në figurën 2.

Figura 2. Shpenzimet e përgjithshme janar-gusht në vite.




Burimi: Ministria e Financave.

Shpenzimet korrente

Shpenzimet korrente në fund të muajit gusht 2013, kanë arritur në rreth 217.0 miliardë lekë. Krahasuar me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar në rreth 64.5 për qind, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, këto shpenzime rezultojnë rreth 12.4 miliardë lekë më të larta ose rreth 6.1 për qind më shumë.

Figura 3. Shpenzimet korrente për periudhën janar-gusht.




Burimi: Ministria e Financave.

Shpenzimet e Personelit Brenda shpenzimeve korrente, shpenzimet e personelit që përfaqësojnë rreth 21.3 për qind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës janar-gusht 2013, rezultojnë pothuajse në nivelin e parashikimit të periudhës. Kundrejt planit vjetor, këto shpenzime në fund të muajit gusht janë realizuar në rreth 64.4 për qind të tij, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet e personelit rezultojnë rreth 1.1 miliardë lekë më të larta ose rreth 2.5 për qind më shumë.

Shpenzimet për paga janë rreth 2.4 për qind më të larta se një vit më parë ose rreth 920 milionë lekë më shumë se një vit më parë, ndërkohë që shpenzimet për kontributet për sigurimet shoqërore janë rreth 194 milionë lekë më shumë ose rreth 3.2 për qind më të larta krahasuar me vitin paraardhës. Ndërkohë që shpenzimet për pagat rezultojnë rreth 1.3 për qind mbi nivelin e parashikimit të periudhës, shpenzimet për sigurimet shoqërore janë realizuar rreth 2.0 për qind nën këtë nivel, duke qenë në të njëjtën kohë përkatësisht shpenzimet për paga rreth 66.7 për qind e planifikimit vjetor dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore në rreth 65.0 për qind e këtij planifikimi.

Figura 4. Shpenzimet për pagat janar-gusht.




Burimi: Ministria e Financave.

Shpenzimet për Interesa Shpenzimet për interesa që përfaqësojnë rreth 13.1 për qind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës janar-gusht 2013, rezultojnë me

një kursim kundrejt parashikimit të periudhës prej rreth 3.6 miliardë lekë, rrjedhojë kjo e kursimit për rreth 1.8 miliardë lekë në interesat e brendshme dhe rreth 1.7 miliardë lekë në interesat e jashtme. Kundrejt planit vjetor, interesat janë realizuar në rreth 55.7 për qind, ndërsa krahasuar me një vit më parë, ato rezultojnë rreth 1.5 miliardë lekë më të larta ose rreth 5.6 për qind më shumë. Ecuria e shpenzimeve për interesa gjatë periudhës janar- gusht, në vite jepet në figurën 5.


Figura 5. Shpenzimet për Interesa janar-gusht.



Burimi: Ministria e Financave.

Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes gjatë periudhës janar-gusht 2013 arritën në rreth 22.3 miliardë lekë, duke qenë rreth 1.4 milionë lekë mbi nivelet e parashikuara. Këtu duhen mbajtur parasysh edhe përdorimet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe nga fondi i kontigjencës të evidentuara më sipër. Në të njëjtën kohë, ato rezultojnë në rreth 67.9 për qind të planit vjetor.


Figura 6. Shpenzimet O&M janar-gusht.



Burimi: Ministria e Financave.

Shpenzimet për Subvencione Shpenzimet për Subvencione në fund të muajit gusht 2013 arritën në rreth 1.0 miliardë lekë ose rreth 16 milionë lekë më pak se parashikimi, ose rreth 101.6 për qind e planit të periudhës, duke arritur në rreth 63.5 për qind të planit vjetor. Krahasuar me vitin e kaluar, këto shpenzime rezultojnë rreth 460 milionë lekë më të ulëta ose rreth 31.2 për qind më pak.


Figura 7. Shpenzimet për Subvencione janar-gusht.



Burimi: Ministria e Financave.

Shpenzimet për Fonde Speciale Shpenzimet për fonde speciale gjatë periudhës janar-gusht 2013 rezultojnë rreth 1.3 miliardë lekë më pak apo rreth 1.5 për qind nën nivelin e parashikimit të periudhës. Kundrejt planit vjetor, shpenzimet për fondet speciale janë realizuar në nivelin 64.1 për qind, nga të cilat sigurimet shoqërore janë realizuar në rreth 66.1 për qind të planit vjetor, sigurimet shëndetësore në rreth 62.4 për qind dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve në rreth 39.1 për qind të këtij plani. Krahasuar me një vit më parë, shpenzimet për sigurimet shoqërore rezultojnë rreth 3.8 miliardë lekë më të larta ose rreth 6.5 për qind më shumë ndërsa shpenzimet për sigurimet shëndetësore rezultojnë rreth 584 milionë lekë më të larta, ose rreth 3.1 për qind më shumë. Shpenzimet për kompensimin e pronarëve në fund të muajit gusht 2013 rezultojnë rreth 317 milionë lekë nën parashikimin e periudhës. Krahasuar me një vit më parë, këto shpenzime rezultojnë rreth 196 milionë lekë më pak ose rreth 21.8 për qind më të ulëta.

Figura 8. Shpenzimet për Sigurimet Shoqërore janar-gusht.




Burimi: Ministria e Financave.

Shpenzime të Pushtetit Lokal Shpenzimet e pushtetit vendor zunë rreth 8.9 për qind të shpenzimeve korrente. Për periudhën janar-gusht 2013 ato kanë arritur në rreth 19.4 miliardë

lekë nga rreth 18.3 miliardë lekë të planifikuara për këtë periudhë të vitit 2013, duke rezultuar me një tejkalim prej rreth 1.1 miliardë lekë ose rreth 5.9 për qind mbi parashikimin e periudhës. Kundrejt planit vjetor, këto shpenzime kanë arritur në rreth 66.2 për qind të tij. Krahasuar me një vit më parë, këto shpenzime rezultojnë rreth 2.1 miliardë lekë më të larta ose rreth 12.1 për qind më shumë. Ecuria e shpenzimeve të pushtetit vendor për periudhen janar-gusht për disa vite jepet në figurën 9.


Figura 9. Shpenzimet për pushtetin lokal janar-gusht.



Burimi: Ministria e Financave.

Pagesa e Papunësisë Pagesa e papunësisë është realizuar në rreth 83.1 për qind të parashikimit të periudhës, duke qenë rreth 54.5 për qind e parashikimit vjetor dhe rreth 130 milionë lekë më pak ose rreth 19.3 për qind më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndhima ekonomike gjatë periudhës janar-gusht 2013 rezulton rreth 1.4 miliardë lekë më shumë ose rreth 11.5 për qind mbi parashikimin e periudhës, duke qenë në të njëjtën kohë rreth 79.6 për qind e planit vjetor. Kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, ndihma ekonomike rezulton rreth 1.9 miliardë lekë më shumë ose rreth 15.7 për qind më e lartë.

Figura 10. Shpenzimet për mbrojtjen sociale janar-gusht.



Burimi: Ministria e Financave.


Kompensimi për të përndjekurit politikë, në fund të muajit gusht 2013, arriti në rreth 2.9 miliardë lekë, ose rreth 290 milionë lekë më shumë se parashikimi i periudhës, duke qenë në të njëjtën kohë rreth 96.3 për qind e planit vjetor. Kundrejt një viti më parë, këto shpenzime rezultojnë rreth 1.4 miliardë lekë më të larta.

Shpenzimet Kapitale Shpenzimet kapitale deri në fund të muajit gusht 2013, janë realizuar në rreth 57.8 për qind të planit vjetor, plan që mban në konsideratë edhe të ardhurat, prej 12 miliardë lekë të siguruar nga privatizimi i katër hidrocentraleve (pasi është

zbritur pagesa e prapambetur e TVSH-së së rimbursueshme për shoqërinë Kurum, prej rreth 3.5 miliardë lekësh). Këtu duhet të mbahet parasysh se rreth 99.4 milionë lekë janë dhënë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për investime. Brenda këtyre shpenzimeve, investimet me financim të brendshëm janë realizuar në masën 72.4 për qind, ndërkohë që investimet me financim të huaj janë realizuar në masën 45.8 për qind të parashikimit vjetor.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, investimet e brendshme rezultojnë rreth 8.9 miliardë lekë më të larta ose rreth 49.0 për qind më shumë, ndërkohë që investimet me financim të huaj rezultojnë rreth 3.0 miliardë lekë më të larta ose rreth 16.9 për qind më shumë. Për rrjedhojë, investimet në total në fund të muajit gusht 2013 janë rreth 33.1 për qind më të larta ose rreth 11.9 miliardë lekë më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Figura 11. Shpenzimet kapitale janar-gusht.



Burimi: Ministria e Financave.

Struktura e investimeve kapitale të realizuara gjatë periudhës janar-gusht 2013 është rreth 56.4 për qind nga financimi i brendshëm dhe rreth 43.6 për qind nga financimi i huaj.